

Angazhohu Monitoro Vepra



SUPLEMENT NGA GRUPI MONITORUES I KËSHILLIT BASHKIAK, POGRADEC, DHJETOR 2012

Qytetar, që kërkesa jote

të mos mbetet dëshirë e paplotësuar,

Eja të monitorojmë bashkë

vendim-diskutimet, për ta realizuar!

Monitorimi
i Këshillit
Bashkiak,
Pogradec
Dosja Nr. 8,



-PËR VLERA REALE TË TITUJVE TË NDERIT.....	faqe 2
-REFLEKTIM MBI PROJEKTIN “ANGAZHOHU-MONITORO-VEPRO”.....	faqe 2
-NJË EMËRTIM DEMODE (?!).....	faqe 3
- RRUGA “KUSH”?.....	faqe 3
- KRENARIA E QYTETIT - PASQYRË PËR TË ARDHMEN.....	faqe 4
-NDIHMA EKONOMIKE - NJE DETYRIM LIGJOR APO NJE LEMOSHE ELEKTORALE.....	faqe 5
-BASHKOHUNI, PËR T’I DHËNË FUND DHUNËS NDAJ GRAVE!.....	faqe 6-7
-TË THUASH TË VËRTETËN	faqe 8



OPINION

PËR VLERA REALE TË TITUJVE TË NDERIT

Dhimitër Gegprifti

Kohë më parë e kemi trajtuar këtë problem nën titullin: "Tituj nderi pa kritere". Motivimi për ta rimarrë edhe njëherë temën e këtij shkrimi janë bërë praktikant e Këshillave Komunarë dhe atij Bashkiak në rrethin e Pogradecit për të dhënë tituj nderi. Në pikëpamje ligjore ata mbështeten në nenin 32, shkronja "m dhe ll", të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore".

Problemi, që kemi trajtuar dhe po e trajtojmë edhe tani, sipas nesh, është mungesa e një vizioni të qartë, për konceptin "tituj nderi" dhe akoma më i rëndësishëm është fakti: praktika, që ndiqet për dhënien e tyre. Jo më pak e rëndësishme është dhe praktika, që ndiqet më pas. Viti 2012 do të mbetet në historinë e Shqipërisë, si viti i një fundshekulli për Pavarësi dhe Shtet Shqiptar. Shqipëria në fillimet e këtij shekulli ka kaluar nga një përvjetor në tjetrin, deri në atë shekullor, si ky që po festojmë sivjet.

Është e natyrshme dhe dinjitoze që midis aktivitetesh kushtuar këtij jubileu

edhe titujt e nderit kanë zënë një pjesë të aktivitetit të Pushtetit Vendor dhe atij Qendror. Por kanë krijuar edhe shqetësime qytetare të natyrave të ndryshme, sidomos ato që kanë të bëjnë me çëmërimet e shesheve apo objekteve, me nivelin e figurave të përzgjedhura, e të tjera.

Synimi do të ishte evidentimi i vlerave të reja, kontributeve të veçanta në të mirë të vendit, rivlerësimi i figurave të anatemuara nga sistemi monist, duke sjellë vlera të reja edhe për historiografinë e qytetit, të zonës, por dhe atë kombëtare.

Nga një vëzhgim i kujdesshëm në këtë lloj aktiviteti, të bie në sy fakti se Pushtetet Vendore po mbushin dosjet për figura të zonës apo të qytetit, vetëm me: "Qytetar Nderi", "Krenaria e qytetit", "Nderi i Qarkut", "Nderi i Komunës". Është shkuar edhe më tej, kur ndonjë komunë ka marrë padashur dhe kompetenca shkencore në këtë fushë. Dhe këtu nuk është faji i tyre, por një mangësi e ligjit të cituar, i cili nuk përcakton kriteret themelore dhe cilët tituj dhe nivelin që duhet të japë Pushteti Vendor, se pa frikë mund të themi se do të ndodhë që "të

ndërhyjnë" edhe në kompetencat e Presidentit të Republikës. Mund të japë ndonjë komunë: "Nderi i Kombit", "Mjeshtër i Madh i Punës", "Artist i Merituar" apo dhe "Artist i Popullit", e të tjerë si këta tituj.

Ky nen dhe kjo pikë duhet rishikuar sa më shpejt të jetë e mundur. Drejtues të ndryshëm në Pushtetin Vendor kanë një koncept vulgar, duke parë masivizimin e këtyre titujve dhe personave, si një lidhje dhe mbështetje për komunitetin. Shkohet deri aty sa mendohet, thuhet dhe synohet të kemi nga një, dy, tre... për çdo fshat.

Një e metë tjetër, në këtë aspekt, është miratimi në mënyrë masive, me lista. Kjo ndodhi në Bashkinë Pogradec në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 15 nëntor 2012, ku nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve u paraqitën për miratim: dy emërtime objektsh, njëri nga të cilët riemërtim, dy riemërtime rrugësh dhe emrat e 24 qytetarëve "Krenaria e Qytetit".

Titujt e nderit, në radhë të parë, janë vlerësim i punës dhe i vlerave të krijuara nga individë të ndryshëm, në kohë të ndryshme, në dobi të

komunitetit, por edhe të kombit, janë vlera të dallueshme nga të gjithë. Ata shërbejnë si stimul për të shkuar më tej dhe si modele për të tjerët. Por këto arrihen, kur ata bëhen publikë dhe marrin edhe miratimin e komunitetit, ku kanë jetuar apo jetojnë. Ky do të ishte treguesi më i mirë i efektivitetit të këtij vlerësimi. Nëse do të njihesh me CV-të e këtyre qytetarëve, në të shumtën e rasteve kanë karakter biografik, nuk evidentojnë vlera, që e dallojnë nga të tjerët, të cilat meritojnë të vlerësohen.

Praktika për të ndërruar emërtime objektsh apo rrugësh në jubile si ky, duket se nuk janë shumë të studiuara e të motivuara. Nuk quhet aktivitet kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë, nëse emrin e patriotit të madh Ismail Qemali, Vlora e heq nga një rrugë dhe e vendos në një tjetër këtu në Pogradec! Organizimi i një ceremonie shpërndarje të këtyre titujve e mbyll këtë aktivitet dhe mendohet për të tjerë. Nuk përbën vlerë të spikatur dhe reale kryerja 'mirë' e profesionit apo e funksionit që ke pasur, ajo ka qenë detyrë.

REFLEKTIM

MBI PROJEKTIN "ANGAZHONU-MONITORO-VEPRO"

Hedh shikimin rreth një panorame të përgjithshme mbi angazhimin dhe pjesëmarrjen time në "Ndërgjegjësohu-Monitoro-Vepro" dhe mund të them e sigurt se ka qenë një ndër projektet më frytdhënëse dhe me një rol mjaft të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Të jesh pjesë e një projekti të tillë, ku grupi i monitorimit duke përdorur lupën e vëzhgimit, bën që të dalë në dritë roli i këshillit në tërësi, absolutisht ka qenë një nga eksperiencat që më ka përcjellë mjaft impresione pozitive.

Nëse do kthehesha pak në retrospektive, kujtoj që kemi zhvilluar disa seanca trajnime përgatitore mbi projektin monitorues. Veç kësaj, zhvilluam

një studim anketues tek të gjithë qytetarët e Pogradecit se sa të informuar ishin ata mbi mbledhjet e



këshillit. Pra, ky projekt ka qenë mjaft i ngjeshur, jo vetëm me trajnime dhe aktivitete të ndryshme, por ka pasur dhe një fluks të gjerë aktivistësh, pjesëmarrësish e

mbështetës të këtij iniciimi.

Për mua kjo eksperiencë ka qenë shumë të vyer, pasi u njoha nga afër me funksionimin e qeverisjes lokale dhe se sa transparente ishte puna e tyre; jo vetëm kaq, por ishte pikërisht ky projekt, që shtoi njohuri në formimin tim dhe më formoi akoma më shumë në intelektin tim. Edhe pse s'mund të le pa përmendur faktin e njohjes së shumë njerëzve të rinj, pjesëmarrës të këtij projekti, studentë me formime profesionale të fushave të ndryshme, e jo vetëm kaq, por na dha mundësinë e njohjes me trajnerë të një background-i mjaft të gjerë, me origjinë vendase apo dhe të huaj, etj...

Ka ndodhur, që shpeshherë mes grupit monitorues të lindin diskutime të forta mbas përfundimit të mbledhjeve, diskutime të zgjatura dhe pa asnjë anshmëri politike, pasi secili nga ne i shikonte çështjet me syrin realist, ashtu si në të vërtetë

duhet të funksionojnë. Por, ajo çka mendoj se vlen më shumë për t'u përmendur është fakti se ndihesha mirë, që më në fund po më jepej mundësia për të bërë diçka pozitive për qytetarët e Pogradecit, ndër të cilët është edhe familja ime, miqtë apo të afërmit e mi... Ndër të cilët jam edhe unë, pasi besoj se të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak Pogradec, të jenë ndërgjegjësuar sadopak nga roli ynë si monitorues dhe kam bindjen që secili prej tyre, nën efektin vëzhgues, është munduar për të qenë sa më transparent dhe efektiv në rolin dhe punën që bëjnë.

Shpresoj që të ndërmerren herë pas here iniciativa të tilla me subjekt ndërgjegjësues të vendimmarrësve lokalë, pasi kjo do jetë arma e vetme që aktivitetet e tyre të jenë më transparente dhe të hapura për qytetarët, por do të shërbejë dhe në dobi të komunitetit tonë.

Leonida Karaj

REFLEKTIM

NJË EMËRTIM DEMODE (?!)

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, të mbajtur më datë 14 nëntor 2012, u votuan me shumicë votash pothuajse të gjitha projekt-vendimet që përmbante rendi i ditës. Para votimit nuk u diskutua shumë, pasi në Komisionin e Ekonomisë, apo edhe atë të ligjeve, ishte bërë një diskutim paraprak. Një pikë, e cila nxiti debat, ishte ajo e ndryshimit të emrit shkollës “30 Vjetori i Çlirimit” dhe pyetja ishte: *A duhet të ndryshohet ky emërtim dhe pse?*

Sipas arsyesimit të disa prej këshilltarëve, kjo shkollë ishte ndërtuar kur ishte 30 vjetori i çlirimit dhe tani meqenëse kanë kaluar vite nuk duhet të jetë aktual ky emërtim. *Po pse?* Dhe pikërisht këtu unë dua të ndalem pak.

Çdo objekt, çdo rrugicë, çdo cak i qytetit mbart nga pak histori. Atë histori që e ka gdhendur secili qytetar apo qyteti vetë, apo të dy

së bashku. Historia e qytetit së bashku me emrat e rrugëve të tij, lagjeve, (apo mëhallëve të dikurshme fëmijërore) nuk duhen tjetërsuar, kjo sepse mund të tingëllojë çuditshëm për kohën që jetojmë (!).

Ajo shkollë ka fiksuar në kujtesën qytetare një datë mjaft të rëndësishme, me të cilën janë njohur breza që kanë lindur në një kohë tjetër, në një kohë ku fjala “çlirim” mund të dukej disi utopike.

Dhe që prej asaj date ka

vazhduar ecuria arsimore dhe edukative e objektit në fjalë, duke pasur po atë emër, ashtu siç do të duken utopike emërtimet e reja që ne vendosim sot dhe që shërbejnë si pikë referimi për ata të cilët do të vijnë më pas. Natyrshëm më vjen parasysh një “portë” e cila ndodhet në hyrje të shëtitores “100 hapa drejt Evropës” dhe pikërisht kjo portë tregon në kuptimin artistik të saj vështirësitë dhe ecejaket e dëshirës sonë për t’u futur drejt të përbashkëtës evropiane. Me

logjikën e lartpërmendur në rastin e shkollës “30 Vjetori i çlirimit”, *a mos duhet që ditën kur ne do të jemi pjesë e BE-së duhet ta heqim këtë objekt?* Besoj se jo.

Kjo, pasi ajo mbart një pjesë të historisë sonë, të rrugës jo pak të lehtë drejt Evropës që ne kemi bërë dhe vazhdojmë të bëjmë. Jo vetëm në qytetin tonë, por edhe gjithandej ndodh një mbivendosje e të resë mbi të ashtuquajturën ‘të vjetër’. Por ne padashur harrojmë se secila prej tyre duhet të ketë vendin e vet, nuk mund të krijojmë diçka duke fshirë tjetrën.

Është mjaft e lehtë me anë të një vendimi, ndoshta edhe pak të nxituar, të ndryshosh emrin e një rruge, një lulishteje, apo parku të vogël. Por ajo që nuk ndryshohet dot është kujtesa e qytetarëve, pasi një objekt fsheh një histori dhe një histori kthen në kohë një kujtim.

Ledion Zeqollari



RRUGA “KUSH”? (!)

INFORMACION PËR PROJEKT -VENDIMET MBI EMËRTIMET E INSTITUCIONEVE DHE RRUGËVE TË QYTETIT TË POGRADECIT

Mbledhja e Këshillit Bashkiak, e mbajtur me 15.11.2012, diskutoi mbi projekt-vendimin “Për emërtimin e rrugëve dhe shëtitoreve të qytetit” bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 9270 “Për sistemin e adresave”.

Ky projektvendim u propozua në kuadër të 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, për të nderuar kontributin e dhënë nga të parët tanë, si edhe sakrificat e tyre për këtë moment historik të kombit shqiptar.

Lidhur me ndryshimin e emërtimit të shëtitores “1 –Maji”, u vendos që segmenti i kësaj shëtitoreje, e cila fillon te rruga përballë Komisarariatit të Policisë dhe mbaron te Bar-Restaurant-Hotel 1-Maji, të marrë emërtimin “Shëtitorja Ismail Qemali”, emrin e patriotit atdhetar, plakut të urtë dhe të mençur, i cili ngriti në Vlorë flamurin shqiptar, në 28 nëntor të vitit 1912,

duke e shpallur Shqipërinë të pavarur. Gjithashtu, segmenti tjetër i shëtitores nga Komisarriati i Policisë dhe deri në hyrjen e qytetit nga Tirana, të marrë emrin e patriotit

Po ashtu, u diskutua në projekt-vendimin përkatës edhe emërtimi i ‘Qendrës Kulturore të Fëmijëve të qytetit Pogradec’ me emrin e intelektualit, mjekut, studiuesit të

shkollën 9-vjeçare të qytetit të Pogradecit, e emërtuar deri tani si “30-Vjetori i Çlirimit”, që të marrë emrin e mësuesit të shquar pogradecar Kozma Basho, për meritat e veçanta në shërbimin e arsimit në rrethin tonë.

Këto ishin ndryshimet e propozuara që u diskutuan edhe në mbledhjen e Këshillit Bashkiak. Në përmbyllje të këtij relacioni më duhet të reflektoj mbi mendimin e qytetarëve të Pogradecit lidhur me këtë çështje. Ata nuk janë aspak të informuar në lidhje me emërtimet e reja të rrugëve dhe bulevardeve. Për shumicën e qytetarëve, emrat e vendosur në këto rrugë janë të panjohur për ta.



Gjokë Risto Kondakçi. Veç kësaj, rruga e emërtuar deri tani “Ismail Qemali” të riemërtohet rruga “Veterani”

shquar, shkrimtarit Themistokli Sotir Marko, për kontributin e gjerë në fushën e kulturës.

Një emërtim i radhës është për

Ligerta Karaj

VENDIMARRJA LOKALE

KRENARIA E QYTETIT - PASQYRË PËR TË ARDHMEN

**Nga: Doralda Tanellari
Xhensila Topçiu**

Ditën e enjte, në datën 15.11.2012, në orën 10:00, u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak. Pika 7 e projekt- vendimit ishte "MBI SHPALLJEN KRENARIA E QYTETIT TË POGRADECIT". Personat e propozuar për të marrë titullin "Krenaria e Qytetit" ishin fillimisht 24 qytetarë të Pogradecit, të cilët i përkisnin fushave të ndryshme të artit, kulturës, sportit dhe më pas u propozuan edhe 3 qytetarë të tjerë.

-Por si mund të marrë një qytetar titullin e nderit?
-Mbi çfarë kritere do t'i atribuohet ky titull?

Tashmë, kushdo që kërkon të marrë titull "Qytetar Nderi" i Pogradecit apo vlerësime të tjera të këtij lloji e që jepen nga Këshilli Bashkiak i Pogradecit, i nënshtrohet një vlerësimi. Ky kalim filtrash do të jetë i pashmangshëm, ndërkohë që kandidati duhet të plotësojë disa kushte. Që të jesh qytetar nderi duhet të kesh kontribuar për qytetin, të kesh përcjellë vlera të cilat janë përthithur nga mendja dhe veprimtaria e qytetarëve nga brezi në brez. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e fundit, mes shumë diskutimesh, kishte si rend të ditës edhe dhënien e titullit "Krenaria e Qytetit" të Pogradecit 24 personaliteteve të shquara të qytetit tonë, ku u propozuan dhe 3 persona tjerë, si: Z. Nikolla Naço, i cili u shpall "Qytetar Nderi", Z. Ylli Pilari dhe Z. Ysen Sokoli u shpallën "Krenaria e Qytetit" të Pogradecit. Personalitete të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre profesional, por dhe human, dhanë një kontribut të pazëvendësueshëm në qytetin e Pogradecit dhe më gjerë.

Figurat e shquara të qytetit, për mendimin tim, dalin vetë në pah dhe më pas marrin përkrahjen e personave që i vlerësojnë kontributin, i propozojnë dhe i votojnë për të qenë në fondin e artë të të qenit "Krenaria e Qytetit". Në këtë përfundim kanë arritur pothuajse të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak të Pogradecit, të cilët në mbledhjen e radhës për vitin 2012, pas projekt- vendimit "Për emërtimin e rrugëve dhe shëtitoreve", kanë qenë njëzëri se ai që do të kërkojë një titull nderi duhet të plotësojë disa kritere vlerësimi. Analiza e të dhënave dhe e veprimtarisë të qytetarëve të propozuar u bë me dyer të mbyllura për t'u dhënë mundësinë Këshilltarëve të Bashkisë të komentojnë, vlerësojnë apo edhe analizojnë lirshëm secilin prej qytetarëve të propozuar. Fakti është që nga 25 qytetarëve të propozuar iu miratua titulli "Krenaria e Qytetit" dhe 2 prej tyre "Qytetar Nderi" të Pogradecit.

Këshilltarëve nuk ju është dashur një kohë e gjatë për t'u menduar apo edhe për të debatuar, duket se këto figura të qytetit kanë qenë të mirëmenduar përpara se të propozohen për

miratim. Apo...?!

Secili prej tyre e meriton një titull të tillë, sepse në njëfarë mënyre apo në tjetrën ata/ato, ka dhënë nga puna dhe jeta e tij çfarë ka mundur për qytetin. Të gjithë duhet t'i njohim kush janë dhe mënyra më e mirë është t'ua bëjmë të ditur gjithë qytetarëve të Pogradecit është me një paragraf të shkurtër për gjithsecilin dhe veprimtarinë e tyre për qytetin.

Z. Agim Shaban Simixhi

Lindur më 1947 në qytetin e Korçës. Mbaron shkollën e mesme Skënderbegas në Tiranë. Më 1971 kryen studimet në Fakultetin e Mjekësisë dhe më 1973 kryen specializimin për Obstetrikë Gjinekologji. Në 1974 fillon kontributin e tij si mjek dhe për një periudhë 10 vjeçare si drejtor i pavionit të maternitetit. Doktor Agimi gëzon respektin dhe dashurinë e mbarë komunitetit Pogradecar.

Z. Theodhoraq Jani Mariani

Lindur në qytetin e Korçës më 1943. Më 1962 kryen studimet në degën Biologji Kimi të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Ka dhënë një kontribut shumë të çmuar në arsim, si mësues, drejtor shkolle, pedagog.

Z. Vasfi Ahmet Cake

Ka lindur në fshatin Guras të rrethit të Pogradecit në vitin 1938. Ka punuar me devotshmëri gjatë gjithë jetës së tij si infermier dhe narkotizator dhe teknik allçie, natyra e doktor Vasfiut kërkonte që të ishte

Z. Bardhyl Vasil Shuke

Bardhyli lindi në Pogradec më 1935, mbaroi studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dega Bio-Kimi. Bardhyli mbahet mend si një arsimtar dhe drejtues i përkushtuar i shkollave të rrethit.

Z. Jovan Naum Shuke

Në vitin 1963 mbaron shkollën e mesme Artistike 'Jordan Misja' në Tiranë dhe emërohet mësues muzike në shkollat e qytetit. Profesor Jovani ka një meritë të veçantë në organizimin për herë të parë të Festivalit të Fëmijëve dhe Pionierëve që vazhdoi deri në vitin 2008.

Z. Mihallaq Kristaq Kole

Mihallaqi lindi në Pogradec më 1930 dhe në 1954 kreu studimet në Kanto në Liceun Artistik "Jordan Misja" në Tiranë. Gjatë veprimtarisë së tij krijuese si dirigjent, kantautor dhe instrumentist në estradë ai ka krijuar këngë të muzikës së lehtë.

Znj. Vasilika Gaqi Burrnazi

Vasilika ka dhënë një kontribut shumë të çmuar në qytetin e Pogradecit. Mbas mbarimit të studimeve në Fakultetin e Histori Filologjisë Dega 'Gjuhë Letërsi' fillimet i ka si mësuese në shkollën XII-vjeçare "Reshit Çollaku" për disa vite, më pas në Shkollën "Koli Gusho" dhe tre vite në vazhdim në Kabinetin Pedagogjik.

Z. Dhimitraq Zisi Ristollari

Dimitraqi ka lindur në Pogradec më 1942. Ka qenë pjesë e Ekipit të Yllit të Kuq qysh prej vitit 1958 deri më 1977. Gjatë veprimtarisë së tij sportive është munduar që me kontributin e tij të bëjë të mundur realizimin e ëndrrës së çdo tifozit për të parë ekipin e zembrës sa më lart.

Z. Guri Gjergji Papajani

Edhe Guri ka lindur në Pogradec më 1933. Ka filluar aktivitetin e tij sportiv që në moshë të vogël, ku dhe ka qenë pjesë e ekipit, Dragoi të Pogradecit. Përveç kontributit si futbollist Guri ka qenë dhe trajner i ekipit të Pogradecit.

Z. Kostaq Risto Lushka

Lindi në Pogradec më 1938. Kostaqi i ka dedikuar jetën e vet karrierës së sportit të futbollit. Një nga emrat që çuan ekipin e Yllit të Kuq në pedestalin që meritonte, gjithashtu ka marrë pjesë në shumë spartakiada në rang Qarku dhe në rang Republike.

Z. Ilia Thomo Llakmani

Ilia Lakmani ka lindur në Pogradec më 1936. Është aktivizuar në lojërat me dorë qysh në vitin 1953 e në vazhdim ka përfaqësuar Ekipin e Volejbollit të Pogradecit denjësisht në kategorinë e dytë dhe në atë të parë. Më vonë, ekipi ku luante Ilia u bë bërthamë ekipit të volejbollit për të rriturit në Pogradec.



gjithmonë në gatishmëri në përballimin e urgjencave sa herë që e kërkonte detyra.

Z. Sokol Sotir Koci

Lindur më 1948 në qytetin e Pogradecit. Pasi mbaron Liceun Artistik, në vitin 1972 diplomohet në Akademinë e Arteve të Bukura në degën Skulpturë Parku. Pas diplomimit emërohet në punë në disa institucione të artit dhe kulturës shqiptare.

Z. Llazi Spiro Icka

Lindur më 1948 në qytetin e Pogradecit. Pasi mbaron Liceun Artistik, në vitin 1972 diplomohet në Akademinë e Arteve të Bukura në degën Skulpturë Parku. Llazi lindi në një nga familjet më të vjetra dhe të respektuara të qytetit të Pogradecit dhe të njohur në mbarë vendin si mjeshtra drupunues dhe mobiljebërës.

VENDIMARRJA LOKALE

vijon nga faqja 4

Z. Leonidha Nasi Sinatka

Leonidha Sinatka lindi në qytetin e Bilishtit më 1937. Në vitin 1957 transferohet në Pogradec në vitin në të cilin fillon dhe aktiviteti i tij sportiv me ekipin e Luftëtarit të Shkollës së Bashkuar.

Z. Masar Mehdi Medini

Masari ka lindur në Filat të Çamërisë në 1941. Aktivitetin sportiv e ka filluar qysh herët me ekipin e të rinjve të qytetit të Shkodrës. Në vitin 1971 u emërua në qytetin e Pogradecit si Sekretar i Komitetit të Fizkulturës, me detyrën e organizimit të aktiviteteve lokale.

Z. Mihallaq Vangjel Busho

Mihallaqi rrjedh nga një familje e thjeshtë dhe punëtore. Në rini ka qenë shumë aktiv në lëvizjet e luftës Nacionalçlirimtare. Në vitin 1950 ka mbaruar kursin për infermieri në Shkodër. Gjatë viteve 1953 deri në 2000 ka dhënë kontributin në fushën e sportit, duke ju dhënë sportistëve ndihmën e parë.

Z. Anesti Pandi Xoxe

Anesti ka lindur në 1936. Veprimtarinë sportive e ka filluar qysh herët, por pjekurinë sportive e ka filluar në qytetin e Pogradecit. Ka luajtur shumë

ndeshje me Ekipin e Yllit të Kuq për shumë vite me radhë ka qenë dhe kapiteni i ekipit.

Z. Niko Stefan Naço

Niko Naço ka lindur në Pogradec më 1942. Ka dhënë një kontribut shumë të vyer në sportin e notit së bashku me Jovan Krëste në vitet 1967-1969 si ndihmës trajner.

Z. Robert Dhimitër Shkurti

Robert Shkurti ka lindur në qytetin e Pogradecit më 1941. Fillimet e aktivitetit sportive i ka pas vitit 1953, kur fill pas përfundimit të Kampionatit të Volejbollit organizuar nga Shoqëria "Spartak" e Elbasanit, një grup shokësh filluan stërvitje për t'u bërë pjesë e Ekipit të Volejbollit të "Yllit të Kuq".

Znj. Silvana Andrea Pjetri

Silvana Pjetri, (Sata) lindi në qytetin e Korçës 1962. Veprimtarinë sportive e ka filluar qysh herët me klasën sportive një traditë e vjetër e asaj shkolle. Nga vitet 1976 deri më 1980 është aktivizuar me ekipin e të rejave të Basketbollit, vite të arta për skuadrën, ku falë kontributit të Silvanës, doli edhe kampion kombëtar dhe në të njëjtën kohë do ta kualifikonte skuadrën e "Yllit të Kuq" në kategorinë e parë.

Z. Vasil Risto Laçka

Vasil Lacka lindi në qytetin e Pogradecit me një veprimtari të shumëllojshme sportive, ndër të cilat duhet përmendur kontributi i tij në fushën e futbollit. Në vitin 1955 u përfshi në ekipin e të rriturve, ku ekipi ynë ishte përbërës i ekepeve të kategorisë së dytë.

Z. Virxhil Vasil Llakmani

Ka lindur në Pogradec më 1935. Në vitin 1962 ndoqi kursin e trajnerit të Volejbollit në Tiranë, ku dhe u diplomua. Menjëherë pas diplomimit u kthye në vendlindje, ku dhe drejtoi skuadrën e volejbollit për meshkuj. Në vitin 1971-1972 mori ekipin e vajzave të volejbollit dhe ishte ai vit kur dhe skuadra për herë të parë në historinë e saj hyn në kategorinë e parë.

Znj. Shaniko Kurti Hamzallari

Shaniko Hamzallari është banore e qytetit të Pogradecit, me një veprimtari të pasur sportive, në të cilat duhet përmendur sporti i basketbollit. Shaniko ka qenë një nga basketbollistet e para ku skuadra e "Yllit të Kuq" debutonte në kategorinë e parë. Ju detyrohemi shumë qytetarëve, që me kontributin e tyre, i dhanë shumë qytetit të Pogradecit. Le të jenë këta njerëz edhe pasqyra ku ne brezi i ardhshëm duhet të shikojmë veten.

NDIHMJA EKONOMIKE

NJË DETYRIM LIGJOR APO NJË LËMOSHË ELEKTORALE

Në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak në qytetin e Pogradecit, mes të tjerash, u miratua edhe këtë herë vendimi i të drejtës për të përfituar ndihmën ekonomike për kategoritë e familjeve në nevojë në qytet. Edhe këtë herë,



këshilltarët miratuan me votë unanime këtë pikë të rendit të ditës. Kaloi pa debat "ndoshta" çështja më e nxehtë mbase e këtyre 20 viteve të fundit, e debatuar shumë herë nëpër zyrat dhe familjet e qytetit.

Pyetja shtrohet kudo: Sa e meritonjë këto familje ndihmën ekonomike? A ka të tjera familje në qytet, që duhet të hyjnë në këtë skemë dhe cilat janë kriteret ligjore kur një familje i plotëson këto kushte?

Personat, që kërkojnë ndihmë ekonomike, janë rritur ndjeshëm kohët e fundit në qytetin tonë. Kjo situatë vjen edhe për shkak të ligjit të miratuar nga qeveria ku parashikohet që një sërë shtresash të tjera të mund të marrin ndihmën ekonomike. Projektligji parashikon si kategori të re përfituesish të ndihmës ekonomike, siç janë: viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe jetimët. Kërkesa për të përfituar ndihmën bëhet me shkrim nga kryetari i familjes dhe firmoset nga të gjithë anëtarët

madhorë të saj, duke deklaruar edhe personin madhor që duhet t'i administrojë mjetet financiare.

Kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike janë disa, por ajo që do merret parasysh është gjendja e varfërisë që bëhet e ditur si nga përfituesit, por dhe nga Institucioni i Ministrisë së Punës. Gjithashtu, përcaktohet edhe kur hiqet ndihma ekonomike, kur personi në moshë pune, anëtar i familjes në nevojë, nuk merr pjesë në punë apo shërbime. Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune, nuk i llogariten si masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen. Masa mujore e ndihmës sipas strukturës së familjes, procedurat dhe dokumentacioni, kohëzgjatja e kriteret, që duhen të plotësojnë familjet dhe individët në nevojë për kushtëzimin e fitimit të ndihmës ekonomike, si dhe mënyra e përlogaritjes së kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike, përcaktohen me

Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), kompetencat të kaluara tashmë shërbimeve sociale të qeverisjes vendore.

Nga ana tjetër, sipas këtyre ndryshimeve që riformulon këtë skemë, zgjatet në kohë përfitimi i jetimëve deri në kohën kur punësohen, ndërkohë që më parë ky përfitim gëzohej prej tyre deri në moshën 18 vjeç. Gjithashtu, parashikohet që skema e ndihmës ekonomike të zgjerohet me viktimat e familjeve që vuajnë nga dhuna, si dhe fëmijët që janë në ngarkimin dhe kujdesin prindëror të vetëm një prindi, personave të emëruar nga organi i kujdestarisë apo vendosja e organizuar në një familje.

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet në nevojë;
2. Jetimët, të cilët nuk janë në institucione;
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në momentin e punësimit të tyre;

Pikërisht kësaj skeme, iu shtuan për muajin Tetor edhe 14 familje. Ndërsa, përfitojnë pagesë paafësie për muajin Nëntor, në total 1712 persona me fond 14 482 780 lekë, të ndarë 938 persona të paafë dhe të verbër, persona para dhe tetraplegjikë me fond 11 959 980 dhe invalidë pune 774 persona, me fond 2 522 800.

Një numër kaq i lartë i personave në nevojë tregon një ulje të të ardhurave në familjet pogradecare të kësaj kategorie, pasoja e së cilës ka sjellë një problem social të theksuar.

Mariglen Vreto

DEKLARATË PËR SHTYP

BASHKOHUNI, PËR T'I DHËNË FUND DHUNËS NDAJ GRAVE!

Ngjyra lejla, simboli i luftës kundër dhunës ndaj gruas qëndroi krahas ngjyrave kuq e zi të 100 Vjetorit të Pavarësisë, duke treguar edhe një herë që jemi një komb i qytetëruar dhe i emancipuar.

Duke filluar nga 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Gruas, deri më 10 Dhjetor, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, njerëz dhe organizata në të gjithë botën janë bashkë me mesazhe dhe aktivitete të përbashkëta, në mbrojtje të të drejtave të grave, si pjesë e të drejtave të njeriut.

Kjo periudhë 16-ditore përfshin edhe data të tjera të rëndësishme si 1 Dhjetorin, Dita Botërore e Luftës Kundër AIDS dhe 6 Dhjetorin që shënon përvjetorin e Masakrës së Montrealit, etj. Fushata 16–ditore është përdorur si strategji nga individë dhe grupe përreth botës për t'i thënë Ndal Dhunës Ndjaj Gruas:

Duke rritur shkallën e ndërgjegjësimit kundër dhunës gjinore si një problem i të drejtave të njeriut në nivele lokale, kombëtare, rajonale e ndërkombëtare; forcuar punën lokale mbi dhunën ndaj gruas; krijuar një lidhje të qartë midis aktivitetit lokal e ndërkombëtar për t'i dhënë fund dhunës ndaj gruas; duke krijuar një metodë për të bashkëndarë dhe zhvilluar strategji të reja dhe efektive; duke

treguar solidaritet me gratë në mbarë botën, duke u organizuar kundër dhunës ndaj grave; duke krijuar mekanizma për të ushtruar presion mbi qeverinë për të realizuar premtimet e bëra.

Shoqata “Unë, Gruaja” për disa vite rresht, është bërë pjesë e Fushatës dhe ka kontribuar për sensibilizimin e komunitetit në rajonin Pogradec-Korçë për dhunën sistematike që shkel dinjitetin dhe personalitetin e gruas. Ajo është pjesë aktive dhe bashkëpunon me të gjithë aktorët e Mekanizmit dhe Trajtimit të Referimit të Rasteve kundër Dhunës në Familje dhe ka gjetur mbështetjen e tyre për t'i thënë JO këtij krimi.

Spoti i realizuar këtë vit jep mesazhet e aktorëve të këtij mekanizmi, nën moton “Dhuna të trajtohet atje ku ndodh!”

Në ditën e hapjes së Fushatës, 25 nëntor 2012, një grup të rinjsh vullnetarë pranë shoqatës “Unë, Gruaja” shpërndanë fjalë e materiale të tjera sensibilizuese për fushatën në qendër të qytetit. Ndërkohë ekipi i vajzave të Beach Volley, me trajnerin Llazi Kërzhalli, për të dytin vit radhazi i bashkohen fushatës duke shpërndarë në të



gjithë qytetin postera të 16 Ditë Aktivizëm.

Zyra Arsimore Pogradec, sensibilizoi të gjitha shkollat, drejtuesit e stafin mësimdhënës, për të shpërndarë materialet e fushatës. Falenderojmë në veçanti shkollën 9-vjeçare “Koli Gusho”, “M.& E.Minarolli”, “Rilindja”, shkollën e mesme “Gjergj Pekmezi”, “Muharrem Çollaku”, personat e kontaktit Violeta Velillari, Rrëmenj, Najada Mëngri, Mëmëlisht, Dhimitra Bardhi, Tushemisht, Kadrie Bufi, Rodokal, si dhe degën e Universitetit “Fan Noli” në Pogradec.

Sot, më 10 dhjetor, po mbylлим 16 Ditë Aktivizëm, që sivjet kishte temën: “Nga Paqja në shtëpi, tek paqja në botë”

Sot, më 10 dhjetor, do të rikujtojmë edhe një herë arritjet tona të përbashkëta në luftën kundër dhunës ndaj grave.

Sot, do të shkojmë një hap përpara në përpjekjet tona të përbashkëta, për ta luftuar dhunën atje ku ndodh, me ndihmën e ligjit dhe të gjithë institucioneve të angazhuara për ta bërë këtë gjë.

Sot aktorët e Mekanizmit të Bashkërendimit të Punës për Referimin dhe Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare nënshkruan marrëveshjen për fuqizimin e këtij mekanizmi.

Treguan kështu që janë një model angazhimi e përkushtimi.

Sot aktorët e Mekanizmit të Referimit nënshkruan marrëveshjen për fuqizimin e këtij mekanizmi. Duke treguar kështu që janë një model angazhimi e përkushtimi.

Falënderime të përzemërta sot shkojnë për të gjithë ata që i dhanë gjallëri qytetit tonë duke shpërndarë postera, fletëpalosje, fjalë, banera, etj. Ngjyra lejla, simboli i luftës kundër dhunës ndaj gruas qëndroi krahas ngjyrave kuq e zi të 100 Vjetorit të Pavarësisë, duke treguar edhe një herë që jemi një komb i qytetëruar dhe i emancipuar.

Falënderime për **Bashkinë Pogradec**, kryetarin e saj z. Artan Shkëmbi, që përkrahu nismën tonë për të nënshkruar në këtë ditë këtë marrëveshje të rëndësishme.

Falënderime për shoqatën “**Refleksione**” dhe drejtoren ekzekutive Monika Kocaqi, për kontributin e dhënë që prej vitit 2008 për ngritjen e “Mekanizmit Referues”, për nxitjen e funksionimit të tij, për ideimin e marrëveshjes dhe mbështetjen në ditën e sotme për ta finalizuar këtë marrëveshje.

Falënderim për median lokale, **televizionin Sot7**, drejtuesin dhe stafin e tij, për pasqyrimin e aktiviteteve sensibilizuese të fushatës.

Pogradec, më 10.12.2012



BASHKËPUNIMI I AKTORËVE TË MEKANIZMIT TË REFERIMIT



Eleni Jajçari

Gjatë vitit 2012 shoqata “Unë, Gruaja” ka zbatuar projektin “Refero Dhunën në Familje-Mekanizmi kundër dhunës në veprim”, me mbështetjen e Kvinna till Kvinna/ SIDA, në kuadër të angazhimeve si anëtare e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Referimit dhe Trajtimit të rasteve të Dhunës në Familje në Pogradec.

Duke bashkëpunuar me sukses me aktorët:

Zyra për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje - Bashkia Pogradec, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Prokuroria e Rrethit, Komisariati i Policisë, Zyra e Përmbartimit, Mjeku Ligjor, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria Arsimore, Zyra e Punësimit, Shoqata “Unë, Gruaja”, Dhoma e Avokatisë, etj realizuam një sërë seminaresh ku ndamë së bashku:

-Eksperiencë, ekspertizë, përkushtim profesional, angazhim për të zbatuar të gjitha detyrimet e dala nga ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “ Për Masa ndaj dhunës në Marrëdhëniet Familjare”

MISIONI I SHOQATËS “UNË, GRUAJA”

“Fuqizimi dhe integrimi i gruas dhe të rinjve në jetën sociale, kulturore, politike, si edhe krijimi i mundësive të barabarta për ta, në zonën Pogradec-Korçë”

Po kështu konferenca e mbajtur më 13 tetor 2012, “Histori suksesi-Mekanizmi kundër dhunës në veprim”, mbështetur nga AMSHC, prezantoi modelin e suksesshëm të këtij Mekanizmi në Pogradec dhe nxori rekomandime për të ardhmen.

Sfidat që na dalin përpara kërkojnë rritjen e nivelit të

bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuara, pjesë e sistemit ndërsektorial të referimit, për zbatimin me përpikmëri të ligjeve për parandalimin e dhunës në familje në çdo formë që shfaqet ajo.

“firmëtarët” e marrëveshjes, dua të falënderoj edhe njëherë donatorin strategjik të shoqatës sonë Kvinna till Kvinna, me mbështetjen e së cilës, shoqata jonë është bërë një shoqatë model dhe me kapacitete për të realizuar misionin:

“Fuqizimi dhe integrimi i gruas dhe të rinjve në jetën sociale, kulturore, politike, si edhe krijimi i mundësive të barabarta për ta, në zonën Pogradec-Korçë.”

Me moton: Jemi gati për sfidën! Ky është momenti ynë!

Në këtë kuadër dua të ndaj me ju lajmin e mirë se para disa ditësh Afroviti Gusho, anëtare e “Unë, Gruaja” dhe një nga themelueset e organizatës, është përzgjedhur nga UN Women (Kombet e Bashkuara, Enti për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Gruas) në Shqipëri, si anëtare e Grupit Këshillimor për Shoqërinë Civile (Civil Society Advisory Group in Albania).



PROJEKTI “ANGAZHOSHU – MONITORO – VEPRO”

EDITORIAL

TË THUASH TË VËRTETËN

Fundviti pritet nga një numër buletini, i cili sjell në faqet dhe kolonat e tij krentin e përmbylljes së këtij projekti vullnetar me një kontribut të vyer, jo vetëm për aktivistët pjesëmarrës, por edhe për opinionin e gjerë pogradecar. Shoqata “Unë, Gruaja” që na bëri pjesë të këtij projekti, ka shprehur mendimin që kjo nismë të vazhdojë. Me monitorime të Këshillit Bashkiak, me buletinin tonë që shënoi numrin 8 këtë dhjetor, pse jo edhe me një sërë idesh të reja se si ne do të zhvillojmë leadershipin e të rinjve në të ardhmen.

Ndihem krenar për publikimet e guximshme dhe të sinqerta të kolumnistëve tanë me përbërje diversive (studentë, gazetarë, funksionarë të pushtetit vendor), duke vlerësuar këtu edhe bashkëpunimin e virtytshëm që na është ofruar nga zonja dhe zotërinjtë të nderuar, si: Artan Shkëmbi, Syrja Palla, Natali Velo, Avdulla Cano, Ilir

Mimini, Mimoza Shuli, Vangjo Gusho, Leonard Berberi, etj.

Ndër këto, kemi rishqyrtuar mes rreshtash edhe disa probleme të reja (sipas objektivit tonë) që i takojnë: Vlerat reale të titujve të nderit; Emërtimi i shkollave duke zhvlerësuar të mëparshmet; Emërtimi i ri i rrugëve dhe informimi i qytetarëve; Ndhma ekonomike; Apel për dhunën ndaj grave; Bashkëpunimi i aktorëve të Mekanizmit të referimit; etj.

Uroj që zëri i qytetarit të mos venitet kurrë në prag presionesh dhe shkeljesh të mundshme gjatë ardhmërisë!

Natyrisht, me një angazhim modest u përpoqëm që të jemi pjesë e pandarë e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe për këtë detyrë qytetare, bëmë të pamundurën të ndërjegjësojmë edhe të tjerë, duke i ftuar për t’u bërë pjesë e kësaj nisme (e vlerësuar si pozitive nga opinioni).



Duhet theksuar që stili dhe eleganca e artikujve mund të variojë me uljengritje profesionale, sepse pjesa më e madhe e të rinjve aktivistë u përfshinë në këtë program me stafetën e vullnetit të mirë, por pa eksperience në faqe gazetash, revistash me opinione dhe analiza. Më duket e udhës të justifikojmë veten duke shpresuar se sollëm para jush shqetësime dhe sqarime të disa çështjeve me interes të përgjithshëm, paçka se jo me profesionalizmin që ju prisnit, por për rastin tonë Albert Einstein do të thosh’:

“Nëse jeni në botë të përshkruani të vërtetën, lërgjani elegancën rrobaqepësit.” – ne nuk përcollëm as më pak, e as më shumë veç së vërtetës. Ndoshta zëri i saj ra në veshë të shurdhër, por ndoshta edhe lëshoi rrënjët e duhura mes njerëzish me vetëdije të lartë qytetare (dhe më besoni, qyteti ynë ka plot të tillë!).

*Me konsideratën më të lartë,
Kryeredaktori Dorian Leka!*



**SOCIETE
GENERALE**

Falënderim i veçantë për Bankën Societe Generale Albania, dega Pogradec që financoi fushatën publicitare të 16 Ditë Aktivizëm, realizuar nga shoqata “Unë, Gruaja”

“Publikimi i këtij suplementi mbështetet financiarisht nga Zyra e Çështjeve Publike e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit Amerikan të Shtetit”